


# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 7027  
E shtunë, 21 tetor 2023  
Çmimi 0.50 €

Kadare flet pas dekorimit nga Macroni: Kosova është Shqipëri, një ditë kjo trevë do ta marrë emrin e vjetër të saj **FAQE 6**



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

EMISARËT NDËRKOMBËTARË SOT (E SHTUNË) VIZITOJNË REPUBLIKËN E KOSOVËS DHE ATË SERBISË **FAQE 4-5**

## 'PESËSHJA E MADHE' SOT ZBARKON NË KOSOVË DHE SERBI



**- BE-ja dhe ShBA-ja pritet ta shtojnë trysninë ndaj Kosovës dhe Serbisë për rinisjen e dialogut dhe zbatimin e marrëveshjes**

I dërguari i BE-së për dialogun, Miroslav Lajčak, bashkë me emisarin e ShBA-së, të Gjermanisë, të Francës dhe të Italisë, do të takohen sot (e shtunë) në Prishtinë me kryeministrin e Kosovës, Albin

Kurti dhe në Beograd me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Ata pritet ta shtojnë përpara vazhdimin e dialogut dhe zbatimin e marrëveshjes drejt normalizimit që Kosova dhe Serbia e kanë arritur gjatë këtij

viti. Kryeministri Kurti të premten nuk ka dhënë ndonjë hollësi për takimin me pesëshen ndërkombëtare. Ai ka thënë se çfarëdo që do të kërkojnë dhe çfarëdo që të ofrojnë ata do të merret vesh në takim

### AKTUALE



**KURTI PËR KËRKESAT E POLICISË: PO BËJMË KREJT ÇFARË MUND DHE DIMË, NA JEPNI PAK KOHË **F. 6****

**BISLIMI NË FRANCË: SERBIA, PALË BLOKUESE NË DIALOG **F. 7****

**PENDAROVSKI: MAQEDONIA E VERIUT DO TË DËRGOJË MË SHUMË USHTARË NË KOSOVË **F. 5****

### EKONOMI



**SHPENZIMET E PARTIVE POLITIKE PËR TREMUJORIN E FUNDIT, PRIN LV-ja ME 330 MIJË EURO **F. 8****

**HAJDARI TAKOHET ME DREJTUESIT E KOMPANISË 'MASDAR', BISEDONJË PËR MUNDËSITË E INVESTIMIT NË KOSOVË **F. 8****

### SPORT



**BALLKANI ME PËRMBYSJE FITON NDAJ LIRISË **F. 10****

## LIGJI PËR KPMSHCK-në PËRFUNDON NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese kërkesën për interpretimin e kushtetutshmërisë për Ligjin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK).

Koordinatori për Drejtësi në Kabinetin për Qeverisje të Mirë të PDK-së, Përparim Gruda, ka thënë se qeveria Kurti është duke dëshiruar ta zhveshë KPMSHCK-në nga kompetencat kushtetuese në një rrugë jokushtetuese



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## OKB-ja thotë se palestinezët po kthehen në veri të Gazës

**NJU-JORK, 20 TETOR** - Një zëdhënese e Zyrës për të Drejtat e Njeriut në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB) ka thënë se ka sinjale të reja që disa palestinezë, që fillimisht ishin zhvendosur në jug pas urdhrimit izraelit për evakuim, po kthehen në shtëpitë e tyre, pasi Izraeli po kryen sulme ajrore edhe në jug të Rripit të Gazës. “Ne mbesim shumë të shqetësuar që sulmet e ashpra ajrore të forcave izraelite në mbarë Gazën, përfshirë në jug.

Sulmet, të kombinuara me kushtet e rënda të jetesës në jug, duket se i kanë shtyrë disa që të kthehen në veri, pavarësisht se në atë zonë po vazhdojnë bombardimet e ashpra”, ka thënë Ravina Shamdasani për gazetaret. Shamdasani ka thënë se Zyra për të Drejtat e Njeriut e OKB-së ka dëgjuar informacione se njerëzit po presin që të kthehen në veri, përfshirë edhe dëshminë e një palestinezi që ka thënë se “më mirë të vdes në shtëpinë time”.

Pas sulmeve vdekjeprurëse të Hamasit ndaj Izraelit më 7 tetor, autoritetet izraelite rrethuan Gazën dhe urdhëruan banorët në veri të territorit të zhvendoseshin në jug. Pas urdhrimit për evakuim, mbi 1 milion palestinezë janë zhvendosur në jug të Rripit të Gazës, por edhe në këtë zonë është raportuar për sulme të vazhdueshme ajrore izraelite. Izraeli është zotuar se do të kryejë pushtim tokësor të Gazës për t'i zhdukur militantët palestinezë të Hamasit.



## Bideni: Mbështetja për Izraelin dhe Ukrainën është jetike për sigurinë e ShBA-së

**WASHINGTON, 20 TETOR** - Udhëheqja amerikane “mban botën së bashku”, ka thënë presidenti i ShBA-së, Joe Biden, gjatë një adresimi, duke theksuar se duhet të thellohet mbështetja e shtetit të tij për Ukrainën dhe Izraelin, në kohën kur këto dy vende po përballen me luftëra të përgjakshme.

Bideni e ka pranuar se këto konflikte “duket se janë larg”, por gjatë adresimit nga Zyra Ovale udhëheqësi amerikan ka thënë se ato mbeten “jetike për sigurinë kombëtare të Amerikës”, përdërisa ai është përgatitur t'i kërkojë Kongresit amerikan miliarda dollarë për mbështetje ushtarake për këto dy shtete. “Historia na ka mësuar se kur terroristët nuk e paguajnë çmimin për terrorin e tyre, kur diktatorët nuk e paguajnë çmimin për agresionin e tyre, ata shkaktojnë më shumë kaos, vdekje dhe shkatërrim. Ata nuk ndalen dhe çmimi i kërcënimit për Amerikën dhe botën vazhdon të rritet”, ka thënë Bideni.

Bideni ka thënë se do të dërgojë një kërkesë urgjente për financim në Kongres për të dy aleatët e ShBA-së të përfshirë në luftëra.

“(Grupi militant palestinez) Hamasi dhe (presidenti rus, Vladimir) Putini paraqesin



kërcënime të ndryshme, por ata kanë këtë të përbashkët: Që të dy duan të zhdukun një demokraci fqinje”, ka thënë Bideni, duke shtuar se fondet për Izraelin dhe Ukrainën “janë një investim i mençur” që do të “paguajnë dividendë për sigurinë amerikane për gjenerata të tëra”.

Para adresimit nga Zyra Ovale, Shtëpia e Bardhë ka thënë se Bideni ka biseduar me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky dhe ka ripërsëritur mbështetjen e Uashingtonit për Kievin i cili po përballlet me pushtimin e nisur nga Rusia në shkurt të vitit të kaluar.

Ndërsa Bideni ka qëndruar në Izrael më 18 tetor për ta shprehur mbështetjen e shtetit të tij, pasi militantët e Hamasit nisën sulmet e koordinuara ndaj Izraelit më 7 tetor, gjë që çoi në një kundërpërgjigje të ashpër të këtij të fundit.

Kërkesa për fonde për mbështetjen e Izraelit dhe Ukrainës, që sipas burimeve të medieve amerikane do të jenë afër 60 miliardë për Ukrainën dhe 14 miliardë për Izraelin, vjen pasi së fundi administrata Biden ka paralajmëruar se po mbaron koha për të parandaluar që Ukraina të humbë fuqinë në fushëbetje,

tekta po vazhdon kundërofensivën e saj raskapitëse kundër forcave ruse.

Ivo Daalder, ish-ambasadori i ShBA-së në NATO, aktualisht shef ekzekutiv i Këshillit të Çikagos për Çështje Globale, i ka thënë “Radios Evropa e Lirë” se me lidhjen e ndihmës për Izraelin dhe Ukrainën, Bideni ia ka bërë më të vështirë Kongresit ta refuzojë pakon e ndihmës.

Kjo ndihmë, që pritet të miratohet, “minon edhe një herë llogaritë e Vladimir Putinit se Perëndimi është buzë kolapsit kur bëhet fjalë për mbështetjen e Ukrainës”.

“Nëse jetoni në Rusi, ju e kuptoni se Ukraina nuk do të shkojë askund, se do të ketë aftësi të vazhdueshme për të luftuar”, ka thënë ai.

Presidenti Biden ka thënë se dështimi për t'i mbështetur Ukrainën dhe Izraelin do ta rrezikojë sigurinë e ShBA-së dhe statusin e saj si “një partnere që shtetet e tjera do të donin të punonin me të”. “Për të rrezikuar gjithçka, nëse ne ndërpresim mbështetjen për Ukrainën, nëse ia kthejmë shpinën Izraelit, thjesht nuk ia vlen”, ka thënë Bideni.

Ai ka shtuar se marrja e vendimeve gjatë kohës kur zhvillohen luftëra “kërkon që të bësh pyetje të

vështira” dhe kërkon “qartësi lidhur me objektivat dhe nëse rruga në të cilën je do të çojë tek objektivat”.

Presidenti amerikan ka thënë se që kur ka nisur pushtimi i Ukrainës, Putini dhe ligjvënës të tjerë të lartë rusë kanë kërcënuar Poloninë, Letoninë, Lituaninë dhe Estoninë, që janë shtete të NATO-s.

Bideni ka thënë se nëse Moska kryen ndonjë sulm ndaj këtyre shteteve, apo ndonjë anëtar tjetër të aleancës, ShBA-ja “do të mbrojë çdo centimetër të NATO-s”.

“Ne nuk duam që trupat amerikane të luftojnë në Rusi apo kundër Rusisë. Nuk mund të lejojmë që terroristët sikurse Hamasi apo tiranët sikurse Putini të fitojnë. Refuzoj të lejoj që kjo të ndodhë”, ka thënë Bideni gjatë adresimit nga Zyra Ovale.

ShBA-ja është mbështetëseja më e madhe e Ukrainës, duke i dërguar deri më tani ndihma ushtarake në vlerë prej 40 miliardë dollarësh. Ndërkaq, zyrtarët amerikanë kanë thënë se do të sigurohen që Izraeli të ketë gjithçka që i duhet për ta mbrojtur veten pas sulmit të Hamasit që ka lënë 1 400 izraelitë të vrarë. Po ashtu, mbi 2 800 palestinezë janë vrarë në Rripin e Gazës nga sulmet hakmarrëse të Izraelit.

## Kryeministrja italiane shkurorëzohet pas 10 vjetësh martesë

**ROMË, 20 TETOR** - Kryeministrja italiane Giorgia Meloni ka njoftuar se do të shkurorëzohet pas 10 vjetësh martesë nga bashkëshorti i saj Andrea Giabruno. Ajo e ka dhënë lajmin në “Instagram”, duke theksuar se rrugët e tyre janë ndarë prej kohësh, por kishte ardhur momenti ta bënë publike tani. Në të njëjtën kohë, ajo ka thënë se do vazhdojë të mbajë një raport të mirë me ish-bashkëshortin tashmë, mbi

të gjitha, për mirëqenien e vajzës së saj shtatë vjeçe. Kryeministrja e Italisë, megjithatë, ka falënderuar partnerin e saj për vitet e mrekullueshme së bashku dhe vështirësitë. “Marrëdhënia ime me Andrea Giabrunon, e cila zgjati gati dhjetë vjet, përfundon këtu. E falënderoj për vitet e mrekullueshme që kaluam së bashku, për vështirësitë që kaluam dhe që më dha gjënë më të

rëndësishme në jetën time, që është vajza jonë Ginevra. Rrugët tona kanë kohë që kanë marrë drejtime të ndryshme dhe tashmë ka ardhur koha ta pranojmë atë. Unë do ta mbroj atë që ishim, do ta mbroj miqësinë tonë dhe do ta mbroj me çdo kusht një vajzë shtatëvjeçare që e do nënën e saj dhe e do babanë e saj, ashtu siç nuk munda të dua unë timin. Nuk kam asgjë tjetër për të thënë për këtë”, ka thënë Meloni.





# Ligji për KPMSHCK-në përfundon në Gjykatën Kushtetuese

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka dorëzuar në Gjykatën kushtetuese kërkesën për interpretimin e kushtetutshmërisë për Ligjin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK). Koordinatorin për Drejtësi në Kabinetin për Qeverisje të Mirë të PDK-së, Përparim Gruda, ka thënë se qeveria Kurti është duke dëshiruar ta zhveshë KPMSHCK-në nga kompetencat kushtetuese në një rrugë jokushtetuese

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 TETOR - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e ka dorëzuar të premtën në Gjykatën Kushtetuese kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë të Ligjit nr. 08/L-180 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 06/L-48 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK). Koordinatorin për Drejtësi në Kabinetin për Qeverisje të Mirë të PDK-së, Përparim Gruda, ka thënë se kjo parti e ka kontestuar shkarkimin e anëtarëve të këtij këshilli, ku Gjykata Kushtetuese i ka dhënë të drejtë dhe ka përcaktuar disa aspekte shumë të rëndësishme të funksionimit të statusit kushtetues të këtij institucioni. "Fatkeqësisht, ky ligj, i miratuar javën e kaluar, i shkelë edhe ato përcaktime që ka bërë gjykata. Prandaj, sot i kemi kontestuar edhe këto ndryshime. Këto veprime të qeverisë kanë

vetëm një qëllim: ta nënshtrojnë dhe ta kapë Këshillin e Pavarur për Shërbyesit Civilë në mënyrë që ai të kthehet në një mekanizëm që nuk i ndalon dhe i përkrah punësimet familjare të qeveritarëve të Kosovës", ka thënë Gruda.

Ai ka thënë se qeveria është duke dëshiruar ta zhveshë këtë organ nga kompetencat kushtetuese në një rrugë jokushtetuese. "Unë mendoj se përkushtimi themelor që duhet ta ketë çdo parti në Kosovë është mbrojtja e Kushtetutës së Kosovës. PDK-ja nuk do të ndalet në këtë drejtim", ka thënë Gruda.

Ndërsa avokati Faton Fetahu ka thënë se janë të paktën katër shkelje të këtij ligji të cilat PDK-ja i ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese dhe të cilat pret të rrëzohen aty. "E para, pushteti zgjodhi që ta propozojë zhveshjen nga imuniteti të të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës. Imuniteti është instrument kushtetues që ua garanton Kushtetuta. E dyta,



shumica parlamentare ka propozuar të përjashtohen nga fushëveprimi i kontrollit të ligjshmërisë nga ana e Këshillit pozitivat e nivelit të lartë drejtues. Janë mijëra pozita të tilla që përjashtohen nga kontrolli – në mënyrë që të mundësohet kapja dhe nënshtimi i institucioneve përmes veprimeve të shpejta. E treta, është rritja absurde e

anëtarëve të këtij Këshilli, nga shtatë në pesëmbëdhjetë. Kjo rritje e numrit ka për qëllim t'i dërgojë militantët partiakë në këtë këshill, që të kenë mbivotim në çështjet që ata dëshirojnë. Dhe, po ashtu, e katërta, është propozimi për pezullimin e vendimeve të Këshillit, nëse të njëjtët atakohen nga qeveria në gjykatë. Vendimet e Këshillit

gjithmonë zbatohen, pavarësisht nëse lënda shkon në gjykatë", ka thënë Fetahu.

Gruda dhe Fetahu janë zotuar se Partia Demokratike e Kosovës do të jetë gjithmonë vigjilente karshi tendencave të pushtetit për ta shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të gjitha ato tendenca do t'i adresojë në Kushtetuese.

## AAK-ja propozon rezolutë mbështetëse për ta përkrahur atë të PE-së lidhur me sulmin terrorist të 24 shtatorit

PRISHTINË, 20 TETOR - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) do të propozojë rezolutë mbështetëse për ta përkrahur atë të Parlamentit Evropian (PE) lidhur me sulmin e 24 shtatorit në Banjskë të Zveçanit, ku ka rënë në krye të detyrës rreshteri i policisë, Afrim Bunjaku.

Lajmin e ka bërë me dije shefi i deputetëve të kësaj partie, Besnik Tahiri, në një konferencë për medie. Rezoluta e PE-së që përmban 28 pika në të cilat flitet për zhvillimet e fundit politike dhe procesin e dialogut e dënon fuqishëm këtë agresion në veri. "Grupi parlamentar i AAK-së do t'i propozojë Kuvendit mbajtjen dhe miratimin e një deklaratë politike për dy çështje. E para, një rezolutë mbështetëse nga Kuvendi për rezolutën e Parlamentit Evropian, e cila si asnjëherë më parë e ka dënuar sulmin në Banjskë. Unë nuk e di a e keni parë këtë rezolutë, por kjo rezolutë e PE-së e dënon në masën më të madhe Serbinë në sulmin terrorist në Banjskë. Nëse e marrim pikën e parë, e



dënon me gjuhë shumë të ashpër dhe e quan sulm terrorist dhe u bënë thirrje vendeve anëtare që nëse nuk e kanë dënuar, ta bëjnë sa më shpejt", ka thënë Tahiri.

Parlamenti Evropian (PE) ka dënuar ashpër sulmin ndaj policisë në Banjskë të Zveçanit më 24 shtator, duke e quajtur sulm terrorist dhe ka kërkuar përgjegjësi nga Serbia nëse

dëshmohet lidhja e drejtpërdrejtë e Beogradit me këtë ngjarje. Këto janë përfshirë në rezolutën për zhvillimet në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe zhvillimeve në veri

të Kosovës.

Teksti i kësaj rezolute është hedhur në votim në seancën plenare të 19 tetorit, kurse është përpiluar duke marrë parasysh disa propozime të grupeve politike në PE. Në tekstin e rezolutës janë përmendur rrethanat të cilat kanë ndikuar në rritjen e tensioneve në veriun e Kosovës, nga largimi i serbëve nga institucionet nëntorin e kaluar, bojkotimi i zgjedhjeve lokale të prillit në veri e deri te vendosja e barrikadave dhe sulmeve ndaj ushtarëve të KFOR-it dhe gazetarëve në fund të majit dhe sulmit të fundit në Banjskë.

Në tekstin e rezolutës sulmi ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë cilësohet "sulm terrorist", përderisa Serbia kritikohet për disa veprime sikurse mosdistancimi i qartë nga sulmi, madhërimi i pjesëtarëve të grupit të armatosur të serbëve që kryen sulmin dhe shpalljen e Ditës së Zisë në Serbi për tre sulumuesit e vrarë.





EMISARËT NDËRKOMBËTARË SOT (E SHTUNË) VIZITOJNË REPUBLIKËN E KOSOVËS DHE ATË SERBISË

## 'Pesëshja e madhe' sot zbarkon në Kosovë dhe Serbi

- BE-ja dhe ShBA-ja pritet ta shtojnë tryshninë ndaj Kosovës dhe Serbisë për rinisjen e dialogut dhe zbatimin e marrëveshjes

I dërguari i BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, bashkë me emisarin e ShBA-së, të Gjermanisë, të Francës dhe të Italisë, do të takohen sot (e shtunë) në Prishtinë me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe në Beograd me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Ata pritet ta shtojnë përpara vazhdimin e dialogut dhe zbatimin e marrëveshjes drejt normalizimit që Kosova dhe Serbia e kanë arritur gjatë këtij viti. Kryeministri Kurti të premten nuk ka dhënë ndonjë hollësi për takimin me pesëshen ndërkombëtare. Ai ka thënë se çfarëdo që do të kërkojnë dhe çfarëdo që të ofrojnë ata do të merret vesh në takim

**EPOKA E RE**

**Lirim GECI**

**PRISHTINË, 20 SHTATOR** - I dërguari i Bashkimit Evropian (BE) për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak dhe emisari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Gabriel Escobar, do t'i vizitojnë sot (e shtunë) Kosovën dhe Serbinë. Lajçaku dhe Escobari do të shoqërohen nga këshilltari për siguri dhe politikë të jashtme i presidentit të Francës Emmanuel Macron, Emanuel Bonne, ai i kancelarit gjerman Olaf Scholz, Jens Plotner dhe këshilltari i kryeministres së Italisë Giorgia Meloni, Francesco Talo. Ata vijnë në Prishtinë dhe Beograd për ta ringjallur dialogun për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë pas sulmit terrorist të 24 shtatorit ndaj policisë në veri të vendit. Diplomatat perëndimorë kanë theksuar se 24 shtatori ka dëshmuar rëndësinë e normalizimit të

marrëdhënieve Kosovë - Serbi dhe kthimin e palëve në tryezën e bisedimeve për zbatimin e marrëveshjes së arritur në Bruksel dhe në Ohër më 27 shkurt dhe 18 mars të këtij viti. Bashkimi Evropian (BE) ka thënë se "kemi pritur të qarta nga palët që ta vazhdojnë procesin e normalizimit dhe t'i përmbushin pa vonesa dhe pa kushte detyrimet e tyre". Presidenti francez Emmanuel Macron ka thënë më 17 tetor në Tiranë se Franca po i ndjek me vëmendje tensionet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke e cilësuar marrëveshjen "një udhërrëfyes solid dhe të mirë". "Mendoj se është përgjegjësi e presidentit (serb Aleksandër) Vuçiq që ta dënojë më vendosmërinë me të madhe aktin e 24 shtatorit. Kjo do të kontribuonte në rivendosjen e qetësisë në kufi", ka thënë Macroni në Tiranë, duke adresuar disa kërkesa për Kosovën dhe Serbinë. "Hapat e ardhshëm dhe çfarë presim nga autoritetet e Kosovës dhe ato serbe janë të thjeshta: riorganizimi i zgjedhjeve

në komunat ku këto janë bërë në kushte të papërshtatshme, pjesëmarrja e serbëve në këto zgjedhje dhe në institucione dhe themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe nga autoritetet e Kosovës. Kushtet duhet të plotësohen në këtë radhitje, në tërësi dhe plotësisht", ka thënë presidenti Macroni, i cili ka nxitur shumë debate me një deklaratë me të cilën ka paralajmëruar Kosovën për mosmbajtjen e premtimeve lidhur me shtensionimin e situatës me Serbinë. "Dua ta them një gjë shumë qartë. Ne kemi bërë një gjest besimi për çështjen e vizave. Për sa i përket Francës, ato (vizat) janë hequr sepse Franca e mban premtimin e dhënë. Ndërsa fjala sot nuk po mbahet", ka thënë Macroni. Fillimisht, komentet e Macronit janë interpretuar nga mediet në Shqipëri dhe në Kosovë si mesazh se Franca po tërhiqej nga vendimi për liberalizimin e vizave. Vendimi i Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave për Kosovën pritet të hyjë në fuqi më 1 janar të

vitet 2024.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë të enjten në mbrëmje në një intervistë në emisionin "Opinion" me Blendi Fevziun se presidenti Macron, "si të gjithë të tjerët, por edhe ndoshta pak më shumë se të tjerët, është vetvetiu i lënduar me faktin që edhe pse është angazhuar personalisht bashkë me kancelarin (gjerman Olaf) Scholz për të vënë në tavolinë një plan që quhet plani franko-gjerman dhe që është gjëja më e mirë që mund t'i ndodhë Kosovës në këtë fazë të historisë së saj dhe duke diskutuar, më tha që unë nuk jam i gatshëm të hap rrugë nëse ata në Prishtinë nuk do t'i hapin rrugë dakordësisë mbi planin franko-gjerman". Rama ka thënë se presidenti Macron ka folur për disa javë në vijim si periudhë e mundësive për Kosovën. "Pra duhet të ketë lëvizje në drejtimin e duhur se nuk mund të merret peng gjithë bashkësia e aleatëve dhe e miqve të Kosovës, nuk mund të merret peng i gjithë komuniteti euroatlantik për t'i bërë karshillëk një përpjekje të tyre, shumë, shumë të vendosur dhe po kaq të sinqertë për ta zgjidhur çështjen e Kosovës", ka thënë Rama.

**Kurti nuk jep hollësi para takimit me emisarët e dialogut**

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, nuk ka treguar se çfarë do të

diskutojë me pesë emisarët perëndimorë për dialog, të cilët sot (e shtunë) do ta vizitojnë Kosovën. Kurti ka thënë të premten se çfarëdo që të kërkojnë ata do të dihet të shtunë (sot). "Çka do të kërkojnë e marrim vesh nesër. Unë mund të them që nuk mund të kemi normalizim pa siguri. Siguria e Kosovës duhet të jetë prioritet edhe për institucionet e shtetit edhe për popullin edhe për shoqërinë. Për këtë punojmë ditë e natë me krejt çfarë mundemi e dimë. Në dhjetorin e vitit të kaluar i kishim tri javë 16 barrikada në veri. Më 26-29 maj të këtij viti patëm sulm mbi policinë, ushtarët e KFOR-it dhe mbi ju gazetarë në veri. Më 14 qershor e patëm rrëmbim e tre policëve tanë në Leposaviq", ka thënë Kurti. Më tutje, Kurti ka folur edhe për sulmin terrorist të 24 shtatorit. "Së fundi më 24 shtator patëm sulm terrorist nga i cili u vra rreshteri i policisë Afrim Bunjaku. Është jetike për Kosovën, për demokracinë, por do të thosha edhe për rajonin e Ballkanit në përgjithësi, që ata të cilët nuk e kanë ditur ose kuptuar se kush është Serbia dhe Beogradi zyrtar, më në fund ta bëjnë këtë sepse nuk është Kosova ajo e cila duhet të ketë masa ndëshkuese, por është Serbia ajo së cilës duhet t'i vendosen sanksionet", ka thënë Kurti, duke shtuar se Kosova çdoherë ka qenë palë konstruktive në procesin e dialogut.



# “Blokua veten”, serbët nga veriu kërkojnë shtyrje të afatit për reregjistrim në RKS

PRISHTINË, 20 TETOR - Nenadi nga Mitrovica e Veriut drejton një veturë me targa KM (Mitrovica e Kosovës) të lëshuara nga autoritetet serbe, së cilës ia ka rinovuar regjistrimin rreth gjashtë muaj më parë. Por, ai nuk mund ta përdorë atë për të lëvizur në jug të Ibrit dhe as për të shkuar në Serbi. Në një prononcim për “Radion Evropa e Lirë”, ai ka thënë se e ka kufizuar lëvizjen e tij duke e zgjatur regjistrimin në sistemin serb dhe ka shtuar se i vjen keq që nuk i ka marrë me kohë targat RKS (Republika e Kosovës). “Po prisja të shihja sa njerëz do të regjistronin (në targa RKS), pastaj do të vendosja”, ka thënë Nenadi.

Targat KM lëshohen nga autoritetet serbe dhe pas marrëveshjes me Kosovën në nëntor të vitit të kaluar, regjistrimi rinovohet në bazë të dekretrit të Qeverisë së Serbisë, pa lëshuar fleta regjistrimi.

Kosova nuk e njeh një reregjistrim të tillë, që në praktikë do të nënkuptonte se ata që e kanë regjistruar veturën e tyre me targa KM në sistemin serb pas nëntorit të vitit të kaluar, nuk mund të lëvizin në territorin e Kosovës. Çështja e heqjes së targave, që Serbia lëshon për qytetet e Kosovës, ka shkakuar një sërë krizash në dy vitet e fundit, si dhe largimin e serbëve nga institucionet e Kosovës në veri në nëntor të vitit 2022.

Afati i Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e targave serbe në Kosovë ka skaduar në prill të këtij viti, por ende në terren ka një numër të madh të automjeteve me targa KM.

## Çfarë do të ndodhë me targat KM?

Nenadi thotë se vendimi i tij për ta rinovuar regjistrimin në targat KM ishte “i gabuar” dhe shton se tani, nëse do të krijohet një mundësi e tillë, ai do t’i merrte targat e Kosovës. “Ajo periudhë e reregjistrimit (në sistemin e Kosovës) ishte e shkurtër. Nuk ia dola. E mendova dhe në fund nuk arrita. Por tani dua ta bëj”, thotë ai. Më 17 tetor zëvendës drejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, në një deklaratë për “REL”-in, ka thënë se qindra qytetarë kanë kërkuar

shtyrjen e afatit për reregjistrimin e automjeteve me targa të Serbisë. Për këtë arsye, një kërkesë e tillë i është përcjellë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës dhe Elshani ka thënë që presin që së shpejti të marrin një përgjigje pozitive.

Mirëpo Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës nuk i është përgjigjur pyetjes së REL-it se a është duke u shqyrtuar një mundësi e tillë, si dhe sa vetura janë reregjistruar në targa RKS deri më tani. Sipas disa vlerësimeve, deri në tetor të vitit të kaluar në komunat e veriut të Kosovës kanë qenë rreth 10 mijë vetura me targa KM.

Këtë lloj veture ende e drejton Miodragu nga Mitrovica e Veriut. Në një prononcim për “REL”-in, ai thotë se Policia e Kosovës nuk u shkakton probleme kur qarkullojnë në katër komunat në veri (Mitrovicë e Veriut, Zvečan, Leposaviq dhe Zubin Potok).

Se qytetarëve në veri me targa KM nuk u shqiptohet gjoha, e konfirmon edhe Veton Elshani nga Policia e Kosovës. Ai ka sqaruar se çështja e targave është bërë “politike” dhe rikujton se procesi i reregjistrimit në RKS është pezulluar dhe se për këtë arsye targat KM, përfshirë ato me regjistrim të rinovuar pas nëntorit të vitit të kaluar, ende “tolerohen”.

## Pse serbët refuzuan të marrin targa RKS?

Një nga arsyet pse pjesëtarët e komunitetit serb në veri të Kosovës nuk iu përgjigjën reregjistrimit është edhe për shkak të “djegies së veturave me targa RKS”. Këtë e konfirmon për “REL”-in edhe Miodragu nga Mitrovica e Veriut. “Veturat e regjistruara në RKS janë djegur. Nuk doja që të më ndodhte kjo dhe pse nuk u reregjistrua. Asgjë nuk ka ndryshuar, por nuk kam zgjidhje dhe tani do të reregjistrohesha”, ka thënë ai.

Pak para skadimit të afatit për reregjistrim më 1 prill, dy vetura me targa RKS janë djegur në komunën e Leposaviqit në veri të Kosovës. Në atë kohë është djegur edhe një veturë me targa të Beogradit. Para kësaj, tri vetura me targa RKS në pronësi të serbëve u dogjën në veri të Mitrovicës dhe Zvečan më 31 mars dhe dy vetura në Zubin Potok



më 30 mars. Po ashtu, edhe në veri të Kosovës është zhvilluar një fushatë kundër reregjistrimit të targave RKS me sloganin “Jo dorëzim, KM mbetet”. Këtë slogan në deklaratat e tyre e kanë përdorur edhe përfaqësues të Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, e cila ka mbështetur e Beogradit. Vetë presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, bëri të njëjtën gjë. “Përgjigjja ime është jo dorëzim. Do ta përsëris, jo dorëzim. Dëshironi edhe një herë? Nuk ka dorëzim, KM mbetet”, u tha ai gazetarëve në një konferencë më 27 tetor të vitit të kaluar.

## A është reregjistrimi zgjidhja përfundimtare?

Igor Marković nga organizata joqeveritare “Aktiv” nga Mitrovica Veriore nuk befasonet nga informacionet se qindra serbë kanë kërkuar nga Policia e Kosovës të shtyhet afati për reregjistrim në targa RKS. Ai ka shprehur besimin se ky proces do të zhvillohet “pa u vërejtur” dhe se nuk do të ketë marrëveshje të reja për këtë çështje në kuadër të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. “Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës do të jetë e mendimit se ky proces është i pashmangshëm dhe se duhet të kryhet në përputhje me udhëzimet administrative të dhëna më herët lidhur me reregjistrimin”, ka thënë ai.

“REL”-i i është drejtuar BE-së për çështjen e targave, gjegjësisht nëse palët do ta rinegociojnë këtë çështje apo jo, por nuk ka marrë përgjigje. BE-ja ka kërkuar më parë nga Kosova dhe Serbia ta respektojnë marrëveshjen nga nëntori i vitit të kaluar deri në arrijten e “zgjidhjes përfundimtare”.

Igor Marković ka theksuar se dalja e

serbëve nga institucionet e Kosovës për shkak të targave çoi në një sërë ngjarjesh që kontribuuan në rritjen e tensioneve në veri të Kosovës dhe se bashkësia ndërkombëtare aktualisht është e fokusuar në “shtensionimin e situatës” dhe jo në targa.

## Kriza në veri të Kosovës për shkak të targave KM

Në shtator të vitit 2021 kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ngriti çështjen e heqjes së targave KM në veri të Kosovës. Pikërisht atëherë janë lëshuar të ashtuquajturat targa testuese gjatë hyrjes në territorin e Kosovës për të gjitha automjetet me regjistrim serb. Ishte një “masë reciproke” sepse lëshimi i targave testuese ka qenë praktikë e kahershme në Serbi për tabelat RKS. Për ta kundërshtuar këtë vendim, serbët në veri të Kosovës vendosën barrikada, por me ndihmën e Bashkimit Evropian u arrit një marrëveshje - vendosja e letrave ngjitëse të bardha mbi simbolet shtetërore si për targat e Serbisë ashtu edhe për ato të Kosovës. Kjo ende është në fuqi, përfshirë edhe targat KM.

Më pas, në fund të qershorit 2022, Qeveria e Kosovës mori vendim për reregjistrimin e të gjitha automjeteve me targa të lëshuara nga Serbia me akronimet për qytetet e Kosovës, si KM (Mitrovica e Kosovës), PR (Prishtinë), GL (Gjilan), UR (Ferizaj) e kështu me radhë.

Me këtë vendim, po ashtu, parashihej që për personat me letërnjoftime serbe të lëshohet dokumenti hyrës/dalës, që ishte edhe masë reciproke ndaj Serbisë. Në prag të fillimit të zbatimit të këtyre vendimeve, më 31 korrik serbët ngritën sërish barrikada, të cilat, megjithatë, u hoqën një ditë

më vonë për shkak se Kosova pranoi ta shtyjë zbatimin e tyre për 30 ditë. Ndërkohë, në fund të gushtit, Prishtina dhe Beogradi arritën një marrëveshje për dokumentet në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve, i cili zhvillohet me ndërmjetësimin e BE-së.

Serbia ka pranuar t’i heqë dokumentet shtesë për hyrje/dalje për mbajtësit e letërnjoftimeve nga Kosova, ndërsa Kosova është pajtuar që të mos i përdor ato për mbajtësit e letërnjoftimeve nga Serbia. Për shkak të kësaj, në fillim të nëntorit të vitit të kaluar serbët janë larguar nga institucionet e Kosovës në veri, dhe pas drejtorit të policisë për rajonin e veriut, Nenad Gjuriq, i cili ka refuzuar ta zbatojë vendimin e Qeverisë së Kosovës për reregjistrim në targa RKS, është pezulluar. Më pas Gjuriqit iu dha “Urdhri i Meritës për Mbrojtje dhe Siguri të Shkallës së Parë” nga presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq.

Me përpjekjet e Bashkimit Evropian dhe ShBA-së, më 23 nëntor 2022 Prishtina dhe Beogradi sërish arritën një marrëveshje në kuadër të dialogut, e cila parasheh që Serbia ta ndalojë lëshimin e targave të reja me emërtimet e qyteteve të Kosovës, ndërsa Kosova procesin e reregjistrimit. Megjithatë, të dyja palët më vonë e interpretuan ndryshe këtë marrëveshje. Më 6 dhjetor 2022 Qeveria e Serbisë ka miratuar një dekret në bazë të të cilit automjetet me targa KM lejohen të lëvizin pa etiketë regjistrimi, gjegjësisht atyre u duhet t’u tregojnë zyrtarëve vetëm një policë sigurimi dhe një certifikatë kontrolli teknik. Prishtina zyrtare e ka interpretuar këtë hap të Beogradit si rritim të regjistrimit me arsyetimin se bie ndesh me marrëveshjen e Brukselit. Kështu, autoritetet e Kosovës aktualisht po “tolerojnë” lëvizjen e automjeteve me targa KM nëpër komunat në veri, të cilat janë të regjistruara në sistemin serb pas arrijtes së marrëveshjes në nëntor të vitit 2022. Mirëpo, me këto targa nuk mund të kalohet vendkalimi kufitar dhe mbetet të shihet nëse do të lejohet një afat tjetër për reregjistrimin e tyre në targa RKS. Në jug të Ibrit targat e Serbisë u hoqën dhjetë vjet më parë në bazë të marrëveshjes në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve.

# Pendarovski: Maqedonia e Veriut do të dërgojë më shumë ushtarë në Kosovë

SHKUP, 20 TETOR - Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, ka thënë se Maqedonia e Veriut dëshiron të dërgojë më shumë ushtarë në Kosovë si pjesë e misionit ushtarak ndërkombëtar të KFOR-it.

Ndër të tjerë, Pendarovski ka thënë për “RIV21” se Kosova me siguri do të jetë një nga temat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. “Jemi me fat dhe kemi nethana të favorshme që jemi anëtarë të NATO-s dhe marrim informime nga Këshilli i Sigurimit i BE-së, përveç luftës Izrael-Hamas,

temë do të jetë edhe veriu i Kosovës. Temë do të jetë edhe Ukraina. Ne duam të dërgojmë më shumë ushtarë në Kosovë”, ka thënë Pendarovski.

Më tutje, Pendarovski ka theksuar se mund të ndodhë që Shqipëria të bëjë më shumë përparim se Maqedonia e Veriut në rrugën drejt Bashkimit Evropian. “Më frikëson se nuk mund të arrijmë një konsensus të brendshëm kombëtar në kryqëzimet kryesore. Mund të debatojmë për gjithçka, por nuk duhet të diskutojmë për interesat kombëtarë”, ka thënë



Pendarovski.

Sipas tij, në vjeshtën e vitit 2019 ai ka paraqitur kërkesë për një metodologji të re dhe ka qenë e qartë se Maqedonia e Veriut nuk do ta marrë dritën jeshile. “Me kërkesë të disa partive politike, ne thirrëm një takim, ku thamë se rikonfirmojmë angazhimin tonë për anëtarësim në BE. Çfarëdo që të ndodhë, ne jemi për BE. Debatu zgjati më pak se një orë. Ne patëm një takim shumë konstruktiv. Askush nuk kishte probleme, derisa shkuan në shtëpi dhe më pas filluan akuzat”, ka thënë Pendarovski.



## 'Supremja u jep të drejtë policëve për pagën e 13, atë jubilarë dhe në shtesa të tjera'

PRISHTINË, 20 TETOR - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Rashit Qalaj, ka bërë me dije se Gjykata Supreme ka dhënë mendim juridik sa i përket të drejtës së pjesëtarëve të Policisë së Kosovës për pagën e 13, atë jubilarë dhe përfitime të tjera. Në "Facebook", ish-drejtori i policisë ka thënë se Qeveria e Kosovës, sipas këtij mendimi juridik të Supremes, është e obliguar t'ua paguajë policëve këto shtesa krahas sigurimit shëndetësor, shtesave për rrezikshmëri dhe pensionimit të parakohshëm. "Gjykata Supreme e Kosovës ka dhënë një mendim juridik për shpërblimin e shujtës

ditore për Policinë e Kosovës, pagës së 13, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilarë në Policinë e Kosovës. Qeveria e Kosovës krahas pagesës së shtesave për rrezikshmëri, sigurimit shëndetësor dhe pensionimin e parakohshëm duhet ti paguaj edhe këto shtesa për Policinë e Kosovës!", ka shkruar Qalaj. Deputeti Qalaj të enjten ishte propozues i një Rezolutive në Kuvendin e Kosovës për përmirësimin e kushteve të punës për pjesëtarët e policisë, e cila nuk kishte kuorum të miratohej për shkak të mungesës së deputetëve të Vetëvendosjes.



## Kurti për kërkesat e policisë: Po bëjmë krejt çfarë mund dhe dimë, na jepni pak kohë



SHTIME, 20 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se kërkesat e policisë janë prioritet i qeverisjes së tij. Për këtë kategori ai ka thënë se duhet të ketë kategorizime e klasifikime në mënyrë që mos të krijohet pabarazi. Për t'i adresuar të gjitha kërkesat, ai ka thënë se u duhet edhe më shumë kohë për, siç ka theksuar, të mos bëjnë gabime e të zvogëlohen defektet. Kurti në komunën e Shtimes, ku

mori pjesë në vënien e gurthemelit të një çerdheje, ka lavdëruar punën e Policisë së Kosovës. "Kjo është një çështje që ne e kemi konsideruar me prioritet. Duhet të kemi klasifikim që mos të krijojmë pabarazi. Na duhet edhe pak kohë që të mos bëjmë gabime që të shkaktojmë zhgënjime e pengesa. Edhe Ligji i Pagave na pati marrë kohë, por koha shtesë ia ka vlejtur ngase i kemi

minimizuar defektet. Ju sigurojmë që po bëjmë krejt çka mund e dimë. Policia është në nivel të detyrës dhe padyshim që e ka mbështetjen e Qeverisë së Kosovës. Na jepni edhe më shumë kohë që mos të bëjmë gabime", ka thënë Kurti. Policia e Kosovës është duke kërkuar që policët të kenë paga më ta larta, sigurime shëndetësore, shtesa për rrezikshmëri etj.

## Policët shqiptarë në ShBA dhurojnë 60 mijë dollarë për familjen e heroit Afrim Bunjaku



NJU-JORK, 20 TETOR - Shoqata e Policëve Shqiptarë në ShBA ka dhuruar 60 mijë dollarë për familjen e policit hero Afrim Bunjaku. Policët shqiptaro-amerikanë të inkuadruar në Shoqatën Amerikane Shqiptare të zbatimit

të ligjit në ShBA, në mjediset e Konsullatës së Republikës së Kosovës në Nju-Jork, kanë dorëzuar çekun e kontributit të tyre në shumë 60 mijë dollarë. Ky çek dedikuar familjes së heroit Afrim Bunjaku në mënyrë simbolike nga disa pjesëtarë të

policisë në Nju-Jersey dhe Nju-Jork si dhe themeluesi i shoqatës, Elton Shametaj, ia kanë dorëzuar drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha. "Ky akt i tyre e bënë krenarë edhe gjithë diasporën dhe mburremi

nga fakti se edhe pse me mijëra kilometra larg, ata bashkëndiejnë rrënjët e origjinës dhe se ritmi i jetës së tyre është i lidhur ngushtë me fatet e atdheut", është thënë në njoftim të shoqatës së tyre. Nuk është ky aksioni i parë që

policët shqiptaro-amerikanë kanë ndërmarrë. Ata edhe më herët, përmes shoqatës së tyre, kanë kryer disa aksione për t'i përkrahur kolegët e tyre në Shqipëri dhe gjithandej trojeve shqiptare. E tërë fushata është realizuar përmes "GoFundMe".



## Bislimi në Francë: Serbia, palë bllokuese në dialog

PARIS, 20 TETOR - Zëvendëskryeministri për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi, ka takuar sekretaren e Shtetit për Çështje Evropiane të Francës, Laurence Boone, me të cilën ka diskutuar për dialogun me Serbinë. Zyra e kryeministrit ka treguar se Bislimi e ka njoftuar zyrtaren e lartë franceze për qëndrimet e palave në dialogun e Brukselit. Ai ka thënë se Kosova është palë konstruktive, ndërsa Serbia bllokuese e procesit. "Sa i përket procesit të dialogut, zëvendëskryeministri Bislimi tha se Kosova në vazhdimësi ka qenë palë konstruktive. Ndërkohë, përmes shkëlqeve të shumta të marrëveshjes bazike,

Serbia ka dëshmuar se është palë bllokuese në këtë proces. Në mesin e këtyre shkëlqeve, ka votuar kundër anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës, duke cenuar nënin 4 të marrëveshjes bazike. Po ashtu, Serbia refuzoi edhe nënshkrimin e marrëveshjes dhe aneksit të zbatimit", është thënë në njoftimin e zyrës së kryeministrit. Sipas këtij njoftimi, Bislimi në takim ka përmendur edhe sulmin terrorist të Banjskë. "Në lidhje me sulmin terrorist të 24 shtatorit, ai theksoi se ishte një akt agresioni i një shteti kandidat për anëtarësim në BE, kundër një kandidati ende potencial për anëtarësim", ka njoftuar zyra e kryeministrit.



## Kadare flet pas dekorimit nga Macroni: Kosova është Shqipëri, një ditë kjo trevë do ta marrë emrin e vjetër të saj



TIRANË, 20 TETOR - Shkrimtari i madh shqiptar Ismail Kadare ka folur për herë të parë pas dekorimit nga presidenti i Francës, Emmanuel Macron. Në një intervistë për "Report Tv", mbajtjen e samitit të Procesit të

Berlinit në Tiranë e ka cilësuar një ngjarje që ndikon pozitivisht në imazhin e vendit. Si zëri i Kosovës në ditët më të vështira tregon mendimin dhe ëndrrën e tij për të ardhmen e saj dhe të shqiptarisë. Ndjesitë për vlerësimin, Kadare

ka preferuar gjatë këtyre ditëve t'i kursejë, siç ka thënë, "për të mos shtuar zhurmajën e madhe", por ka bërë një koment kur Macroni edhe për kufizimet e kapërcyera në diktaturë, përmes letërsisë e konsideron si "Lajmëtar të lirisë".

"Unë kam qenë gjithmonë lajmëtar i lirisë. Çdo shkrimtar i njohur, i ndershëm, është i tillë", është shprehur Kadare. Ndërsa mbajtjen e samitit të Procesit të Berlinit në Shqipëri, shkrimtari e ka shikuar me

optimizëm. "Mendoj se është një ngjarje shumë pozitive për imazhin e Shqipërisë", ka thënë Kadare.

Në këtë ngjarje ku Shqipëria, si dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, synojnë mbështetjen për integrimin në Bashkimin Evropian, dhënia e mesazheve përmes artit dhe vendosja e personaliteteve të kulturës në "vijë të parë" të pritjes së madhe, sipas shkrimtarit, ndikon për mirë. "Çdo gjë që hedh dritë mbi Shqipërinë, që shpërndan mjegullën, errësirën, keqkuptimet, është pozitive", ka thënë ai.

Si një nga figurat që ka ngritur çështjen e Kosovës gjatë luftës së UÇK-së te strukturat më të larta, ku lobonte për lirinë e saj te Papa Gjon Pali II, deri edhe te presidenti i Francës i kohës, Zhak Shirak në vitin 1998, Kadarenë e shqetësojnë konfliktet që trazojnë lirinë e saj. "Mendimi im është ai mendim logjik i të gjithë njerëzve që e duan vendin e tyre. Uroj lirinë e plotë për Kosovën së shpejti! Kosova është Shqipëri dhe një ditë e gjithë kjo trevë do ta marrë emrin e vjetër të saj", ka thënë shkrimtari Kadare.

## Konjufca kërkon mbështetjen e Kanadasë për integrimin euroatlantik të Kosovës

PRISHTINË, 20 TETOR - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, i shoqëruar nga shefi i Kabinetit, Ilir Kërçeli dhe këshilltarët, ka pritur të premtën në takim ambasadorën e re jorezidente të Kanadasë në Kosovë, Jessica Blitt. Gjatë takimit është biseduar për zhvillimet aktuale në vend dhe rajon, për marrëdhëniet e shkëlqyera miqësore dhe bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Kanadasë, si dhe për planet e përbashkëta në

funkcion të forcimit të mëtejshëm të raporteve dypalëshe. Me këtë rast, kryetari Konjufca e ka uruar ambasadorën Blitt për detyrën e re dhe ka shprehur mirënjohjen për shtetndërtimin dhe fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës, duke kërkuar njëherësh vazhdimin e përkrahjes ndaj shtetit tonë në rrugën e integriteteve euroatlantike. Ndërsa ambasadorja Blitt e ka falënderuar kryetarin Konjufca për pritjen dhe ka

ritheksuar gatishmërinë e shtetit të Kanadasë për zgjerimin e bashkëpunimit në fusha të ndryshme dhe avancimin e marrëdhënieve me Republikën e Kosovës. Po ashtu, ambasadorja e Kanadasë është takuar me kryeministrin Albin Kurti. Kryeministri Kurti e ka falënderuar ambasadorën për mbështetjen dhe ndihmën e vazhdueshme të Kanadasë në të gjitha proceset shtetformuese të Republikës së Kosovës. Ai ka shprehur mirënjohjen në veçanti për mbështetjen e dhënë për



zhvillim, avancim të të përkrahjen në procesin e drejtave të njeriut dhe anëtarësimit në organizata barazisë gjinore, si dhe ndërkombëtare.



# Shpenzimet e partive politike për tremujorin e fundit, prin LV-ja me 330 mijë euro

PRISHTINË, 20 TETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka publikuar raportet financiare për tremujorin e tretë të vitit për partitë politike në Kosovë. Sipas raporteve të publikuara nga KQZ-ja, për shpenzime nga muaji korrik deri në shtator prin Lëvizja Vetëvendosje (LV) me 330 mijë e 599.3 euro.

E dyta për nga shpenzimet është Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 164 mijë e 358.7 euro, pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 142 mijë e 421.05 euro dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me 61 mijë e 666.25 euro.

Shpenzimet më të mëdha LV-ja i ka pasur për paga dhe mëditje. Për to ka shpenzuar mbi 193 mijë e 472 euro, ndërsa për qira të zyrave shpenzoi 54 mijë e 291 euro, teksa për shpenzime komunale, telefon dhe internet shpenzoi 6 mijë e 514 euro. Në total për kategorinë e "shpenzimeve të përgjithshme", LV-ja ka shpenzuar 254 mijë e 378 euro. Për shpenzimet e

transportit, LV-ja ka shpenzuar 13 mijë e 619 euro, ndërsa për blerje të mallrave ka shpenzuar 44 mijë e 220 euro.

Partia në pushtet ka pasur edhe shpenzime të përfaqësimit. Për këtë kategori ka shpenzuar 12 mijë e 410 euro, ndërsa për investime dhe logjistikë ka shpenzuar vetëm 339 euro, teksa në kategorinë "shpenzime të tjera" LV-ja i ka dhënë 5 mijë e 630 euro.

Edhe për Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) shpenzimet më të mëdha gjatë tremujorit të tretë ishin në paga. Për këtë kategori i shpenzoi 141 mijë e 28 euro. Për mallra dhe shërbime PDK-ja pagoi 19 mijë e 508 euro, ndërsa për shpenzime të udhëtimit partia më e madhe opozitare pagoi 4 mijë e 930 euro.

Shpenzimet për shërbime PDK-së i kanë kushtuar 3 mijë e 615 euro, kurse ato për blerje të tjera të mallrave dhe shërbimeve patën koston e 3 661 eurove.

1 200 euro PDK-ja i ka shpenzuar edhe për kategorinë "logaritë



përlogaritëse për avance", për shërbime të regjistrimit dhe sigurimeve 375 euro, për mirëmbajtje dhe riparime të tjera 1 mijë e 463 euro, ndërsa për qira u dhanë 1 mijë e 453 euro. Për dreka zyrtare, PDK-ja ka shpenzuar 2 mijë e 827 euro, kurse për shpenzime komunale 2 mijë e

983 euro, teksa për shpenzime komunale dhe shpenzime të ndryshme 739 euro.

Edhe LDK-ja përgjatë tre muajve të fundit më së shumti ka shpenzuar për paga, ku ka dhënë 88 mijë e 759 euro, ndërsa mallrat dhe shërbimet gjatë muajve korrik, gusht dhe shtator i kanë kushtuar 52 mijë e

954 euro. Për shpenzime dhe shërbime, LDK-ja i ka dhënë 40 mijë e 298 euro, ndërsa për shërbimet e telekomunikimit 853 euro. Lëndët djegëse dhe blerjet e tjera të mallrave dhe shërbimeve, LDK-së i kanë 3 mijë e 647 euro, respektivisht 1 mijë e 634 euro. Logaritë përlogaritëse për avance te LDK-ja kanë pasur koston e 1 mijë e 128 eurove, ndërsa shërbimet e regjistrimit dhe sigurimit 647 euro, ndërsa për mirëmbajtje dhe riparime të tjera u dhanë 169 euro. Qiraja për zyrat e LDK-së ka kushtuar 4 mijë e 576 euro, ndërsa shpenzimet komunale 706 euro.

Më së paku shpenzime për tremujorin e tretë ka pasur AAK-ja. Më së shumti para janë dhënë për paga, 48 mijë e 162 euro. Për shpenzime dhe shërbime, AAK-ja ka shpenzuar 1 mijë e 433 euro, ndërsa për blerje të mallrave dhe shërbimeve 2 mijë e 136 euro. Shpenzime pa kategori, AAK-ja ka pasur 8 mijë e 25 euro, ndërsa për shpenzime komunale 1 mijë e 908 euro.

## Hajdari takohet me drejtuesit e kompanisë 'Masdar', bisedojnë për mundësitë e investimit në Kosovë

ABU DHABI, 20 TETOR - Ministri i Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), Rozeta Hajdari, gjatë qëndrimit në Emiratet e Bashkuara Arabe (EBA), ka takuar menaxhmentin e lartë të kompanisë prestigjioze "Masdar", të përfaqësuar nga U. Serkan Ata, me të cilin ka biseduar rreth klimës së të bërit biznes në Kosovë dhe për mundësitë që ofrohen për investimet e qëndrueshme në vendin tonë. Sipas njoftimit të MINT-it, ministri Hajdari gjatë qëndrimit të saj në EBA ka krijuar ura bashkëpunimi me kompaninë prestigjioze të energjisë së ripërtërishme dhe hidrogjenit të gjelbër - "Masdar".

Ministria Hajdari i ka informuar drejtuesit e kompanisë "Masdar", lidhur me progresin ekonomik,



demokratik dhe përparësitë për investime në Kosovë, përfshirë prioritetet e politikave industriale dhe të energjisë, reformat ligjore për të bërit biznes në Kosovë, duke theksuar mundësitë e aplikimit dhe negociimit përmes Ligjit për Partneritet Publiko-Privat, atij për

Investimet e Qëndrueshme dhe Ligjit për Burimet e Ripërtërishme. "Përfaqësuesit e kompanisë 'Masdar' shprehën interesimin për projektet në fushën e energjisë së ripërtërishme dhe për instrumentet të cilat e përkrahin të investuarit në Kosovë, për të cilat

ministria Hajdari njoftoi më hollësisht për instrumentet dhe lehtësimet legislative që nxisin dhe mbrojnë investimet e qëndrueshme në Kosovë. Ajo njëherazi u zotua se do t'i përcjellin informatat shtesë me projektet konkrete në kuadër të Protokollit të

Parë të Komitetit të Përbashkët Ekonomik Kosovë - EBA, ku përfshihet edhe sektori i energjisë", ka njoftuar MINT-i.

Sipas tij njoftimi, ministria Hajdari i ka ftuar përfaqësuesit e kompanisë "Masdar" për ta vizituar Kosovën dhe për t'i parë nga afër mundësitë të cilat ofrohen për investime në vend.

"Masdar" është një nga kompanitë më të mëdha në botë të energjisë së ripërtërishme dhe një lider i hidrogjenit të gjelbër, duke i vendosur Emiratet e Bashkuara Arabe në ballë të tranzicionit të energjisë. Si një pionier në avancimin e sektorit të energjisë së pastër, "Masdar" është aktiv në më shumë se 40 vende në gjashtë kontinente dhe ka investuar në projekte mbarëbotërore.

## Përmbillet panairi "AgroKos", prodhuesit kërkojnë mbështetjen e institucioneve

PRISHTINË, 20 TETOR - Panairi Ndërkombëtar "AgroKos" është përmblyllur të premten në Prishtinë. Në këtë panair kanë marrë pjesë 130 biznese nga shumë vende.

Po në këtë panair kanë marrë pjesë edhe ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhillimit Rural, Faton Peci, ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë,

Rozeta Hajdari, kryetarë komunash etj.

Esat Berisha nga kompania "Arti Fruti" ka thënë se është për herë të parë në "AgroKos". Ai ka thënë se deri më tani nuk ka marrë ndonjë mbështetje nga institucionet shtetërore.

Ndërsa Xhemile Krasniqi nga Shoqata e Bletarëve "Mimfa" nga Obiliqi ka thënë se ka

pasur fatin të përkrahej nga komuna për biznesin e saj, por ka theksuar se kanë nevojë ende për më shumë mbështetje

Ndërsa Bastri Veseli nga "Leoni Group" ka thënë se vitin e kaluar janë subvencionuar nga qeveria, ndërsa këtë vit kanë investuar vetë për shtim të kapaciteteve.





# Dominique Moisi: Lufta e imazheve, që po ndez edhe perëndimin



“Është bërë edhe një luftë fjalësh dhe imazhesh që do të rëndojnë në evolucionin e konfliktit”. Dominique Moisi, këshilltar special i Institutit Montaigne, djali i një të mbijetuarit të Aushvicit, punoi përkrah protagonistëve të marrëveshjeve të Oslos, për të cilat zhvilloi negociata sekrete. Beteja propagandistike rreth masakrës së spitalit të Gazës është pjesë e një mekanizmi që Moisi e analizoi para të tjerëve në esenë e tij të famshme, “Gjeopolitika e emocioneve”, e përkthyer në njëzet e gjashtë vende.

## Beteja e imazheve sapo ka filluar, si të orientohemi?

“Në fillim të luftës në Ukrainë, shkrova se ajo reflektonte divorcin emocional të botës. Perëndimi ishte i bashkuar pas Ukrainës, me pak përjashtime, ndërsa Jugu Global u distancua nga Perëndimi. Ajo që po ndodh në Lindjen e Mesme, në një nivel emocional, është lufta në Ukrainë në kulmin e saj. Ndodh

sepse ka një konflikt kujtese. Nga njëra anë, më 7 tetor komuniteti hebre përjetoj një pogrom të përgjakshëm dhe barbar, në vetë tokën e Izraelit. Dhe nga ana tjetër, ka komunitete myslimane që ripërjetojnë ndjesinë se jeta palestineze ka më pak rëndësi se e të tjerëve. Nga çdo anë, ka një përpjekje për të çliruar emocionet.”

## A rrezikon kjo “mjegull luftime” të minojë mbështetjen e Perëndimit për Izraelin?

“Dilema e Izraelit sot është të rivendosë besueshmërinë e tij strategjike, pa u izoluar plotësisht. Izraelitët janë të vetëdijshëm se mbështetja perëndimore është e fortë, por që mund të luhetet edhe në betejën e imazheve. Izraeli po përpiqet të kufizojë sa më shumë viktimat kolaterale, ndryshe nga Hamasi i cili u kërkon banorëve të qëndrojnë për të shumëfishuar numrin e viktimave, duke i përdorur në

fakt si armë propagande dhe më konkretisht si mburoja njerëzore”.

## A ka ndonjë alternativë ndaj operacionit ushtarak në Gaza?

“Jo. Hamasi duhet të pësojë një disfatë masive, si ISIS apo Al Kaeda. Për Izraelin është çështje mbijetese. Megjithatë, ka dy dilema. E para është se si t'i përgjigjemi traumës pa harruar mësimet e së kaluarës. Po mendoj për Amerikën, për reagimin e tepruar ushtarak pas sulmeve të 11 shtatorit 2001. Dilema tjetër është koha: sa më i gjatë të jetë operacioni në Gaza, aq më shumë Izraeli do të izolohet në sytë e opinionit publik botëror. Nuk mendoj se një sulm i shpejtë është i mundur tani. Izraeli do ta fitojë këtë luftë ushtarakisht, por mund të jetë një fitore si e Pirros, me një disfatë politike dhe me frikën e sulmeve anti-hebreje në vende të tjera. Ekziston rreziku i izraelizimit të shoqërive evropiane, me idenë se do të

duhet të jetojmë nën hijen e terrorizmit”.

## Si të shpëtojmë nga kurthi i ngritur nga Hamasi?

“Është jashtëzakonisht e vështirë. Mesazhi i Hamasit për izraelitët është “Më urre!”. Dhe është shumë e vështirë të mos urresh. Të vjen në mendje formula e përdorur nga Yitzhak Rabini, në fillim të viteve 1990: ne duhet të vazhdojmë negociatat e paqes sikur terroristët të mos ekzistonin. Ne duhet të luftojmë terrorizmin sikur të mos ekzistonin negociatat e paqes. A është i aftë Izraeli ta bëjë këtë?”

## Duket se keni dyshime.

“Hamasi do të shkatërrohet. Por Hamasi i mundur ndoshta do t'i ketë arritur objektivat e tij, që janë të bëjë të pamundur çdo afrim midis izraelitëve dhe palestinezëve, me çdo kusht. Nuk do normalizim mes arabëve dhe izraelitëve, dhe do që ta

shtyjë Izraelin drejt radikalizimit edhe më të madh. Unë e shoh 7 tetorin si fillimin e luftës së pestë të Izraelit. Ishte viti 1948, lufta e pavarësisë, pastaj Suezi (1956), Lufta Gjashtë Ditore (1967), Lufta e Yom Kipurit (1973) dhe tani është lufta në Gaza, por që mund të shpërthejë në frontin verior ose në territoret e pushtuara”.

## A keni frikë se Hezbollahu do të hapë një front verior?

“Aeroplan-mbajtësja amerikane dhe luftanijet britanike që mbërrijnë në Lindjen e Mesme shërbejnë për të bindur Iranin që të mos shkojë në luftë. Ekspertët ushtarakë thonë se Hezbollahu preferon të ruajë pushtetin e tij në Liban, në vend që ta rrezikojë atë në një luftë kundër Izraelit. Nuk jam i sigurt. Unë mendoj se tundimi për t'u ardhur në ndihmë vëllezërve të Hamasit do të jetë i fortë. Do të ketë presion të madh për shkak të imazheve që do të qarkullojnë për ndërhyrjen e armatosur në Gaza”. / [bota.al](http://bota.al)



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



# Ballkani me përmbysje fiton ndaj Lirisë

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 20 TETOR** - Kampioni në fuqi i Superligës, Ballkani, nuk ka lejuar befasi në ndeshjen që e zhvilloi sot ndaj Lirisë, pasi arriti fitore me përmbysje me rezultat bindës 4-1. "Do të thosha se Liria bëri futboll goxha të mirë në pjesën e parë dhe kaloi në epërsi. Rikthimi i Lirisë në Superligë është gjë e mirë. I përhëndes edhe tifozët për korrektësinë e tyre, që kishin ardhur për ta përkrahur skuadrën. Liria i mungonte prej disa vitesh Superligës. Përveç që shënuan gol, patën edhe disa raste. Neve na ndihmoi shënimi i golit në fillimin e pjesës së dytë, më pas goli i dytë erdhi shpejt. Në pjesën e dytë patëm ritëm dhe tani na pret ndeshja e vështirë me Astanan", ka deklaruar pas ndeshjes Ilir Daja, trajner i

Ballkanit. Pas pesëmbëdhjetë minutave lojë, Liria e befasoi skuadrës suharekase duke kaluar në epërsi me golin e shënuar nga Zenunaj. Pjesa e parë e ndeshjes përfundoi me rezultat 0-1. Pjesa e dytë ishte krejt ndryshe dhe Ballkani dominoi plotësisht dhe arriti të shënojë katër gola. Në minutën e 46 për rezultat 1-1 u përkujdes Berisha, ndërsa Dellova (52') e kaloi Ballkanin në epërsi. Kryeziu më pas realizoi dy gola për ta vulosur rezultatit final 4-1.

Ballkani e ruan pozitën e parë me 23 pikë të grumbulluara, ndërsa Liria zë vendin e parafundit me vetëm 6 pikë. "Ballkanit dhe trajnerit Ilir Daja u uroj suksese. Kam besimin e plotë se Superligën e Kosovës do ta përfaqësojnë mirë. Po mundohemi të përmirësohemi në aspektin taktik. Duhet të shfrytëzojmë më shumë, jo vetëm



## SUPERLIGA - JAVA E DHJETË

**Ballkani - Liria 4-1**

**Të shtunën takohen:**  
Gjilani - Fushë-Kosova

**Të dielën takohen:**  
Malisheva - Dukagjini  
Llapi - Drita  
Feronikeli 74 - Prishtina

45 minuta. Nuk kemi mundësi të bëjmë shumë ndryshime në formacion. Ballkani është më i fortë se ne në këtë aspekt. Sot kemi çfarë të marrim me vete dhe kemi çfarë të lëmë. Disiplinën e lojës nga pjesa e parë do ta marrim, kurse do t'i lëmë gabimet e pjesës së dytë. Nuk do të dorëzohemi as unë, as lojtarët dhe as kryesia. Do të bëjmë

gjithçka", ka thënë, pas ndeshjes, trajneri i Lirisë, Nedim Yigit.

Në kuadër të fazës së dytë të kampionatit elit të futbollit, sot (e shtunë) do të zhvillohet vetëm një ndeshje. Gjilani e pret skuadrën e Fushë-Kosovës. Të dielën do të zhvillohen tri ndeshje, përfshi edhe derbin në mes të Llapi dhe Dritës. Kjo ndeshje do të zhvillohet nga ora 13:00 në stadiumin "Zahir Pajaziti". Këto dy skuadra renditen në pozitën dy dhe tre dhe shihen si konkurrentet kryesore të Ballkanit për titullin e kampionit në elitë. Llapi po tregon formë të mirë në këtë edicion dhe synon tri pikët e plota, por për rezultat pozitiv udhëtojnë edhe gjilanasit. Feronikeli 74 e pret skuadrën e Prishtinës, derisa ndeshje interesante pritet të jetë edhe ajo në mes të Malishevës dhe Dukagjinit nga Klina. Të gjitha ndeshjet fillojnë nga ora 13:00.

# Trajneri i Kosovës: Ballkani ka një skuadër pak mbi mesataren



Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës, Primoz Gliha, në një intervistë dhënë për mediumin kroat "Index.hr", ka komentuar ndeshjen Ballkani - Dinamo Zagreb, e zhvilluar në Prishtinë javë më parë në kuadër të fazës së grupeve në Ligën e Konferencës. Ballkani triumfoi 2-0 kundër gjigantit kroat të futbollit në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Gliha gjatë intervistës u pyet për "debaklin" që pësoi Dinamo Zagrebi në kryeqendrën e Kosovës nga Ballkani.

Derisa po e komentonte humbjen e Dinamos, Gliha gjatë vlerësimit për Ballkanin ka thënë

se është ekip me cilësi pak mbi mesataren. "Sigurisht, as për mua nuk është surprizë. Edhe para ndeshjes kam thënë se Dinamo do të ketë probleme të mëdha. Pikërisht për atë njëpërçindëshin e famshëm që përmend gjatë gjithë kohës. Sapo nënvlerësoni kundërshtarit tuaj sot, keni mbaruar. Dinamo nuk ka më as Boban, as Prosineckin, kështu që nëse do të mund të shkonin atje dhe të thonë se do ta fitojnë lehtësisht ndeshjen", ka deklaruar Gliha për "Index.hr". "Ata kanë një skuadër pak mbi mesataren. Sot vështirë se mund të gjesh një lojtar që mund ta zgjidhë lojën

vetë. Sot futboli nuk praktikohet më si dikur, individualisht. Për mendimin tim, gabimi më i madh i futbollit të sotëm është se lojtarët nuk stërviten më për pozicione individuale si dikur, dhe se individualiteti dhe klasi i tyre individual janë mbytur", ka theksuar trajneri i Kosovës.

Primoz Gliha ka qenë vazhdimisht i pranishëm në ndeshjet e Ballkanit në garat evropiane. Madje ai ftoi dyshen e Ballkanit, Qëndrim Zybën dhe Lumbardh Dellovën, në grumbullimin e fundit me Përfaqësuesen e Kosovës në muajin tetor.

# Prishtina - Bashkimi, derbi i Superligës në basketboll

**PRISHTINË, 20 TETOR** - Fundjava do të sjellë ndeshje interesante në xhiron e pestë të Prince Caffè Superligës. Sfidat kryesore pritet të zhvillohet në mes të Sigal Prishtinës dhe Bashkimit. Dy skuadrat numërojnë nga tri fitore dhe një humbje. Dy skuadrat kanë traditë në basketbollin e Kosovës dhe sfidat

mes tyre gjithmonë kanë qenë interesante dhe kështu pritet edhe të dielën.

Ndeshja e parë e kësaj xhiro është ndërmjet Proton Cable Prizrenit dhe Trepçës. Prizrenasit kanë një fitore dhe tri humbje, ndërsa e kundërta është me mitrovicasit që kanë tri fitore e një humbje. Vëllaznimi është



skuadra e vetme në elitë që nuk di për fitore, kurse këtë xhiro e pret

Golden Eagle Yllin që, po ashtu, nuk e ka nisur mirë edicionin e ri, me një fitore e tri humbje.

Java e pestë do të mbyllet me ndeshjen në mes të Pejës dhe Istogut. Pejanët janë skuadra e vetme me katër fitore në elitën e basketbollit, ndërsa istogasit kanë një fitore dhe tri humbje.

## Superliga - Java e pestë

**Të shtunën takohen:**  
17:00 Proton Cable Prizreni - Trepça  
19:00 Vëllaznimi - Golden Eagle Ylli

**Të dielën takohet:**  
16:00 Sigal Prishtina - Bashkimi  
20:30 Peja - Istogut

# Gjyqtari Istref Elezaj shkëlqeu në CEV Challenge Cup

**PRISHTINË, 20 TETOR** - Gjyqtari kosovar me thirrje të FIVB-së, Istref Elezaj, ka marrë vlerësim maksimal gjatë ndarjes së drejtësisë në ndeshjen e raundit të dytë të 1/32 finaleve CEV Challenge Cup, mes VBC Casalmaggiore dhe IGOR Novara. Elezaj ishte

gjyqtar i parë në paraqitjen e tij të pestë në Kupat Evropiane, kur të enjten në Viadana të Italisë ka qenë gjyqtar në duelin e dy ekipeve italiane. Ai mori vlerësim maksimal edhe nga delegati i ndeshjes Filipoo Niedu. Partner në ndarjen e

drejtësisë në këtë ndeshje, Elezaj e pati gjyqtarin polak Wojciech Glod. Kjo ishte ndeshja e kthimit mes këtyre skuadrave, me IGOR Novara që e fitoi edhe ndeshjen e dytë 3:0 (25:13; 25:18; 25:23), për ta siguruar kualifikimin në 1/16 e CEV Challenge Cup. Këto dy

ekipe njihen për rivalitetin edhe në Serinë A në kuadër të së cilës garë do të ndeshen edhe të dielën. Federata e Volejbollit e Kosovës e ka përgëzuar gjyqtarin kosovar Istref Elezaj për paraqitjen brilante në këtë garë, duke përfaqësuar suksesshëm



vlerat e volejbollit tonë në Evropë.



## Perez: Ja ku do të më shihni sezonin tjetër

MILTON KEYNES, 20 TETOR - Piloti meksikan i Red Bullit, Sergio Perez, në prag të garës së Amerikës që zhvillohet këtë fundjavë në pistën e Austinit, ka deklaruar se nuk do të largohet nga Formula 1. Ai ka ende edhe një vit kontratë me makinën

kampione, duke siguruar se, pavarësisht prej rezultateve jo të mira, do të rikthehet fitues. Kohën e fundit drejtuesit e Red Bullit kanë kërkuar më shumë impenjim nga meksikani. "Jam në një moment të vështirë të karrierës time. Gjëja më e lehtë

që mund të bëj tani është të ik, por unë nuk jam një njeri i tillë dhe më pëlqejnë sfidat", ka deklaruar Perez. "Nuk kam as më të voglin dyshim se do të rikthehem në nivelin e dikurshëm, ndaj nuk e mendoj aspak tërheqjen time nga garat

dhe Formula 1. Jam 100 % i sigurt se vitin tjetër do të më shihni sërish në pistë duke pilotuar makinën Red Bull. Këtë e them se kam një kontratë dhe nga bisedat që kam me skuadrën", ka shtuar piloti meksikan.



## Shosholli: Shqipëria është me fat që e ka Jasir Asanin



TIRANË, 20 TETOR - Trajneri i mirënjohur kosovar Ajet Shosholli, në një prononcim për portalin "Open-TV", ka deklaruar se kombëtarja shqiptare është me fat që e ka një lojtar si Jasir Asani, i cili, falë karakteristikave të tij dhe bashkëpunimit me grupin, ka bërë që kuqezinjtë të kenë rezultate të mrekullueshme.

Trajneri kosovar pohoi se ish-sulmuesi i Partizanit ka realizuar gola mjaft të rëndësishëm për

Shqipërinë. "Shqipëria ka bërë një grup shumë të mirë dhe është me fat, pasi ka Jasir Asanin, i cili është bërë një lojtar karakteristik për kombëtaren. Në ndeshjet e fundit ai ka treguar një cilësi, qoftë individuale, por edhe në bashkëpunim me grupin. Asani ka shënuar edhe golat më të rëndësishëm për Kombëtaren e Shqipërisë nga pozicionet e tij karakteristike, nga distanca, ku gjithçka nis nga krahu i djathtë dhe

pastaj vjen finalizimi me këmbën e majtë. Me lëvizjet e tij, duke shmangur kundërshtarët dhe me goditjet e sakta, Asani ka kontribuar, së bashku me të tjetër, duke bërë që Shqipëria të arrijë në këto rezultate aktuale", u shpreh trajneri kosovar. Ajet Shosholli foli edhe për "Dardanët". Sipas tij, përfaqësuesja e Kosovës ka një grup të mirë lojtarësh dhe se nga kjo gjeneratë pret të kualifikohet në ndonjë kampionat evropian ose botëror.

## Ish-ylli i Juventusit dënohet me dy vjet burg për evazion fiskal

LECCE, 20 TETOR - Ish-sulmuesi i Juventusit, Lecces dhe Romës, Mirko Vuciniç, u dënua nga gjykata e Lecces me dy vjet burg, me përfitimin e një dënimi me kusht, për evazion fiskal me akuzën e mosdeklarimeve të të ardhurave. Gjyqtari urdhëroi gjithashtu kompensimin e dëmit jopasuror në favor të Agjencisë së të Ardhurave, palës civile dhe konfiskimin e pasurisë së futbollistit për rreth 5.6 milionë euro. Prokurori publik i prokurorisë së Salentos kishte kërkuar katër vjet burg. Mbrojtësi i lojtarit, avokati Antonio Savoia, kishte kërkuar pafajësinë për moskzistencën e krimin dhe bëri apelin, pasi ishin paraqitur arsyet e dënimit. Vendimi i shkallës së parë



rrjedh nga përfundimi i hetimit nga Guardia di Finanza e cila kreu sekuestrimin ekuivalent më 20 nëntor 2019. Sipas akuzës, gjatë periudhës në të cilën Vuciniç ka qenë nën kontratë për katër sezone me

ekipin "Al Jazira Club" të Emirateve të Bashkuara Arabe, në këmbim të pagës prej 13.5 milionë eurosh, ai nuk ka paguar tatim mbi të ardhurat nga viti 2014 deri në 2017, ndërsa ruante rezidencën në Itali.

### SHKURT

#### Guardiola: De Zerbi do të jetë trajneri i ardhshëm i Cityt

Trajneri italian Roberto De Zerbi i ka të gjitha karakteristikat për të qenë një ditë pasardhësi i Pep Guardiolas te skuadra e Manchester City. Ai që e ka konfirmuar këtë gjë është vetë trajneri spanjoll në konferencën për shtyp, duke vlerësuar punën e bërë nga trajneri aktual i Brightonit. "Ai do të jetë trajneri i ardhshëm i Manchester Cityt. Jua garantoj këtë gjë", ka thënë Guardiola për De Zerbin në prag të ndeshjes që skuadra e tij do ta zhvillojë këtë fundjavë me Brightonin në Premierë Ligë. Guardiola e konsideron De Zerbin trajnerin më të mirë të gjeneratës së tij, një trajner të aftë të influencojë në të ardhmen e futbollit. Italiani ka bërë një revolucion te Brightonit, që është ekipi me më shumë gjuajtje në portë në Premierë Ligë këtë sezon. Gjithsesi, kalimi i De Zerbit te Manchester City nuk ka për të ndodhur shumë shpejt, pasi vetë Guardiola ka një kontratë deri në vitin 2025 me kampionët e Anglisë. Gjithsesi, ai ka gati pasuesin e tij te kampionët e Evropës dhe kjo është një fjalë që peshon.

#### Bellingham: E shoh veten te Reali edhe për 10-15 vjet

Mesfushori anglez Jude Bellingham e ka nisur në mënyrë të shkëlqyer sezonin te Reali i Madridit dhe synimi i tij është të jetë pjesë e kësaj skuadre edhe për shumë vjet. 20-vjeçari i kushtoi Realit 103 milionë euro, por kjo shifër mund të rritet deri në 130 milionë euro varësisht golave që do të shënojë mesfushori. "Reali i Madridit është klubi ku unë dua të qëndroj për 10 ose 15 vitet e ardhshme të jetës sime. Më pëlqen të jem këtu dhe jam përmirësuar shumë që kur kam ardhur, nuk kam asnjë dyshim", ka thënë Bellingham, i cili më pas e ka falënderuar trajnerin Carlo Ancelotti për mënyrën se si po e trajton. "Ancelotti më tha se pozicioni në të cilin luaj tani është ai ku më sheh. Më pëlqen liria që ai më jep dhe të qenët i rrethuar nga lojtarë me aq shumë cilësi më çon në një nivel tjetër", ka shtuar Bellinghami.

#### Sommer: Ne kalojmë çaste të vështira, prej vitesh shkoj te psikologu

Portieri i Interit, Yann Sommer, ka dhënë një intervistë të gjatë në lidhje me futbollin, por edhe me detaje nga jeta e tij. Zvicerani ka zbuluar se prej vitesh shkon te psikologu pasi, siç thekson portieri, në futboll ka raste kur kalojnë momente shumë të vështira. "Çdo futbollist përjeton momente të vështira në karrierë. Unë kam shumë vite që punoj me një psikolog. Ai më ndihmon në momente të caktuara dhe është e rëndësishme të flas me dikë kur gjërat nuk shkojnë siç duhet. Kjo të ndihmon të ndihesh më mirë", ka thënë Sommer.

I pyetur se çfarë vlen më shumë në futboll, talenti apo puna dhe vendosmëria, Sommer ka theksuar se, sipas tij, patjetër që kjo e dyta. "Patjetër puna dhe vendosmëria. Duhet pak talent, sigurisht, por unë kam takuar shumë lojtarë në karrierën time që, ndoshta, kishin më pak talent, por që bënë punë të palodhur dhe shumë pasion, pa u dorëzuar kurrë. Ata arritën nivelet maksimale. Kështu që kërkon shumë vendosmëri", ka deklaruar portieri i Interit.

## Son: Kam rilindur pas largimit të Kanes

Sulmuesi 31-vjeçar koreano-jugor Son Heung-Min ka rilindur këtë sezon, duke qenë protagonist me skuadrën e Tottenhamit. Në tetë ndeshje të luajtura deri më tani, ai ka realizuar 6 gola, duke qenë golashënuesi më i mirë për

"Spursin". "Sezoni i kaluar ishte vërtet zhgënjyes për mua. Psikologjikisht nuk isha në gjendje të jepja 100 % të rendimentit tim në fushën e lojës. Nuk doja t'i zhgënjeja njerëzit", u shpreh koreano-

jugori, një prej idhujve të tifozerisë së Tottenhamit. Askush nuk e priste këtë shpërthim këtë vit të lojtarit, sidomos pas largimit të Harry Kanes, mikut e kolegut të tij në sulmin e Tottenhamit vitet e fundit. Ndërkohë që skuadra drejtohet

nga trajneri i ri Postecoglou. "Këto dy ndryshime, largimi i Kanes dhe ardhja e trajnerit të ri, sollën një rilindje këtë verë për mua. Doja me çdo kusht këtë verë që gjërat të ndryshonin për mua dhe deri më tani gjërat po shkojnë mirë", u shpreh Son. "E

kemi nisur mirë sezonin dhe shpresoj të vazhdojmë sa më gjatë kështu. Uroj të shënoj sa më shumë dhe ta ndihmoj ekipin për fitimin e trofeve dhe arritjen e objektivave. Jam i sigurt se mund të shkojmë larg", ka deklaruar Son.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë  
për Kushtet Ndërtimore

“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin “Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Nr. prot: 2316/23 të datës 03.05.2023, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Ndërtesa e Rilindjes  
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmph-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Telefon: + 381 38 200 32 222



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejta](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejta)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

-Naser Shunjaku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës Teknike “Nexhmedin Nixha”.

Ujëvara Rama nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e testit të maturës të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi”.

Liberta Spahija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat, diplomën dhe certifikatën e maturës të Gjimnazit “Hajdar Dushi”.

Edmonda Kadriu shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme “Xheladin Deda”.

Urimi Rent a car shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër 811430941.

Aksa Advertisement SH.P.K. shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër 811284299.

Besart Sadiku B.I. shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810174673.

B2 SH.P.K. shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit nr. 810129347.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



